

## Fjalim i deputetes Shpresa Marnoj

13.07.2023

– E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë në lidhje me një hua koncensionale për programin “Përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore, pas tërmetit të vitit 2019””, synon apo ka si objektiva specifike përmirësimin e sektorit shqiptar të energjisë elektrike, të bazuar në parimet e tregut dhe në zhvillimin e një sektori modern të energjisë elektrike, me ndërtimin e nënstacioneve elektrike tërësisht të reja apo me riparimin e atyre ekzistuese në zonat e Durrësit dhe Shkodrës, si dhe përmirësimin e lidhjes, cilësisë, efikasitetit të transportimit dhe rrjetit në tërësi, për të nxitur kështu zhvillimin e sektorit familjar dhe atij privat.

Ky projektligj është një propozim i Këshillit të Ministrave, i cili i paraqitet Kuvendit bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 121 të saj, ku Komisioni për Ekonominë dhe Financat e ka shqyrtuar atë, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Kjo hua vjen në kuadër të konferencës së donatorëve “Bashkë për Shqipërinë”, e organizuar në muajin shkurt të vitit 2020, në Bruksel, për masat e rimëkëmbjes, me qëllim financimin nga donatorët ndërkombëtarë pas tërmetit të nëntorit të vitit 2019, ku qeveria e Republikës së Italisë ka dhënë një garanci formale prej 5 milionë eurosh në grante dhe 90 milionë euro në hua koncensionale. Kjo hua koncensionale me kërkesën e qeverisë shqiptare është ndarë, duke rënë dakord që të përdoret për financimin e projekteve dhe importimin e mallrave në shumën e 35 milionë eurove për ndërhyrje në infrastrukturë, me qëllim përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri dhe për përmirësimin e linjave të shpërndarjes në Veri të vendit. Në kuadër të marrëveshjes, qeveria italiane angazhohet në disbursimin e huasë koncensionale, e cila nuk e tejkalon shumën e 35 milionë eurove dhe vjen në terma mjaft të mirë: me një normë interesi prej 0,5%, element granti 60% dhe periudhë shlyerje 25 vjet, nga të cilat 12 vjet do të jenë periudhë mospagimi, gjatë së cilës do të paguhet vetëm interesat. Kjo do të përdoret nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë për mbulimin e kostove aktuale për punimet civile dhe për furnizimet me pajisje dhe shërbime, të cilat do të blihen përmes një oferte konkurruese ndërmjet shoqërive ndërkombëtare, që do të organizohet në Republikën e Shqipërisë. Qeveria shqiptare do të jetë pala që do të sigurojë zbatimin e programit në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje huaje, do të jetë përgjegjëse për përdorimin e huasë koncensionale, për përcaktimin dhe menaxhimin e kontratave, si dhe për mbikëqyrjen e veprimtarive, pasi do të sigurojë disponueshmërinë dhe

sigurimin në kohë të burimeve financiare dhe njerëzore, me qëllim përmbushjen e kërkesave për investimin e projektit, të cilat nuk mbulohen nga huaja koncesionale.

Objekti i kësaj kontrate vjen kryesisht si nevojë e rikuperimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019 në zonat më të prekura, siç është zona Fushë-Krujë – Kurbin (këtu u referohet zonave sipas projekteve të parashikuara në këtë program), por njëkohësisht edhe si nevojë për të ndërhyrë njëherë e mirë në rrjetet ekzistuese tejet të amortizuara, të cilat me kapacitetet që kanë aktualisht nuk përmbushin nevojat e zakonshme të konsumatorëve (kryesisht në zonat rurale apo malore, ku ka ndërprerje të herëpashershme të energjisë si pasojë e defekteve), dhe për të përballuar zhvillimin e këtyre zonave me ndërtime të reja dhe zhvillimin e turizmit përgjatë vijës bregdetare të zonës Shëngjin-Velipojë, që në këtë periudhë përkon me një shtim të fluksit të numrit të turistëve dhe për rrjedhojë nevojat janë shumë herë më të larta.

Gjithashtu, projektet do të shtrihen edhe në qarkun e Shkodrës, duke prekur pothuajse të gjithë zonën, si në Koplík, në Tamarë e më gjerë, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në turizmin malor, i cili kohët e fundit po merr një zhvillim të veçantë.

Kuptohet se të gjitha këto projekte do të marrin kohën e nevojshme për t'u realizuar, por do të zgjidhin përfundimisht problemet më të mëdha të energjisë elektrike në këto zona, duke përmirësuar ndjeshëm zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe jetën e qytetarëve në përgjithësi, e cila është në thelb të përpjekjeve dhe punës së kësaj qeverie ndër vite, duke u kujdesur që vëmendja të shtrihet në çdo sektor apo sistem, si në përmirësimet në infrastrukturën e përgjithshme, në shëndetësi, në arsim, në ujësjellës-kanalizime, në energji, në turizëm, në shërbime të digjitalizuara dhe në shumë fusha të tjera, për të mbajtur një ekonomi stabil edhe në situata të vështira kombëtare apo ndërkombëtare, qofshin këto ekonomike apo politike, madje duke marrë përsipër edhe rritjen e pagave të të gjithë administratës publike, pavarësisht zhvillimeve.

Ndaj, edhe një herë, duke e vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, që prek një ndër sektorët më jetikë, siç është ai i energjisë elektrike, ju ftoj të gjithëve ta miratojmë!

Faleminderit!